

# Zbatimi për herë të parë i SNKSP-ve me të drejta dhe detyrime të konstatuara

Dmitri Gourfinkel dhe Frans van Schaik

16 qershor 2021



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




**PULSAR** 

Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

# Objektivat e dokumentit dhe SNKSP 33



## Objektivi i dokumentit

- ✓ Të jepen udhëzime praktike për zbatimin për herë të parë të SNKSP-ve, në bazë të përvojës botërore
- ✓ Të jepen në formë të përmbledhur konceptet e SNKSP 33

## Objektivi i SNKSP 33


- ✓ Të sigurojë që pasqyrat e para financiare që përdorin SNKSP-të me të drejta dhe detyrime të konstatuara:
  - Të bëjnë raportim transparent për kalimin drejt SNKSP-ve
  - Të shërbejnë si një pikënisje e përshtatshme për përputhshmërinë me SNKSP-të
  - Të realizohen me një kosto që nuk tejkalon përfitimet për përdoruesit

# Struktura e dokumentit



- Hyrje
- Planifikimi paraprak për zbatimin e SNKSP 33
- Njohja dhe matja: parimi i përgjithshëm
- Njohja dhe matja: përjashtime nga parimi i përgjithshëm
- Dhënia e informacioneve shpjeguese
- Përvoja ndërkombëtare
- Përfundime dhe rekomandime

# Dokumenti udhërrëfytes për reformat e KSP-së



- Gjendet në adresën: <https://cfrr.worldbank.org/publications/roadmap-public-sector-accounting-reform-roadmap-template>

# Sfidat për reformat e KSP-së



- 1. Mbështetja politike dhe gatishmëria e palëve kyçe të interesit për nisjen dhe kryerjen e reformës**
- 2. Arritja e marrëveshjes për një strategji të reformës dhe afate të arritshme për zbatimin, duke shmangur objektiva dhe afate jo realiste**
- 3. Ngritja e strukturave të duhura për bashkërendimin dhe administrimin e reformës**
- 4. Gatishmëria e burimeve të nevojshme, përfshirë edhe ato financiare dhe njerëzore**
- 5. Ndryshimi i mjedisit ligjor dhe rregullator**

# Sfidat për reformat e KSP-së



- 6. Përcaktimi i strukturës së sistemit të ri të KSP-së, përfshirë përcaktimin e mekanizmit të vendosjes së standardeve**
- 7. Përcaktimi i mekanizmave për menaxhimin dhe zbutjen e riskut**
- 8. Hartimi i një strategjie për menaxhimin e ndryshimit dhe ngritjen e kapaciteteve, përfshirë strategjitë e komunikimit, informimit dhe formimit**
- 9. Ngritja e nivelit të IFMIS-it ekzistues ose ngritjen e një IFMIS-i të ri paralelisht me zbatimin e reformës së KSP-së**
- 10. Integrimi midis funksioneve dhe sistemeve të ndryshme të MFP-së, përfshirë buxhetin, thesarin, të ardhurat, borxhit, statistikat buxhetore, prokurimin etj., sidomos përmes një IFMIS ekzistues ose të ri**

# Qasja e drejtpërdrejtë kundrejt asaj të tërthortë për zbatimin e SNKSP-ve



## Zbatimi i drejtpërdrejtë

- ✓ Pa e ndryshuar përmbajtjen origjinale të SNKSP-ve
- ✓ Nxiten njësitë ekonomike t'i përdorin drejtpërdrejt SNKSP-të

## Zbatimi i tërthortë

- ✓ Përmes një procesi mbështetjeje të standardeve kombëtare të KSP-së, të harmonizuar me kornizën e SNKSP-ve
- ✓ Kuadri kombëtar zakonisht merr në konsideratë rrethanat që janë specifike për vendin

**SNKSP 33 është i dobishëm si për zbatimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe për atë të tërthortë**

# Qasja me faza kundrejt asaj të menjëhershme për zbatimin e SNKSP-ve



## Me faza (qasja e rekomanduar)

- ✓ Nënkupton vënien progresive në zbatim të përmirësimeve, sipas një renditjeje të planifikuar
- ✓ Qasja me faza u jep mundësi juridiksioneve të dëshmojnë përfitime të shpejta duke mundësuar përmbushjen e disa kërkesave të SNKSP-ve në periudhën afatshkurtër
- ✓ Jep kohë për rritjen e aftësive dhe ekspertizës të lidhura me SNKSP-të, për të ruajtur ritmin e zbatimit.
- ✓ Rreziqet kryesore:
  - Periudha më të gjata të vënies në zbatim
  - Lodhje nga reforma
  - Humbje e forcës shtytëse dhe mbështetjes politike

## I menjëhershëm

- \* Nënkupton kalimin nga sistemi kontabël përpara SNKSP-ve në përputhshmërinë e plotë me SNKSP-të duke filluar nga një datë e caktuar
- \* Në disa juridiksione, është e vetmja mundësi për shkak të kriterëve ligjore të brendshme, që cilat mund të mos e lejojnë një vënie në zbatim me faza
- \* Testimi i të dy sistemeve paralelisht është i kushtueshëm dhe kërkon kapacitete operative shtesë
- \* Rreziqet kryesore:
  - \* Varësi e lartë te konsulentët e jashtëm
  - \* Përdorim i gjerësishëm i aftësive të brendshme organizative
  - \* Vonesë të konsiderueshme në nisje, gjersa të përfundojnë të gjitha përgatitjen e nevojshme zbatimin e plotë.

**SNKSP 33 është konceptuar për një qasje me faza, sepse përfshin disa përjashtime gjatë një periudhe trevjeçare**



# SNKSP 33 bën dallimin midis një faze përgatitore dhe një periudhe kalimtare




## Faza përgatitore

- ✓ Vjen përpara futjes në zbatim të SNKSP 33
- ✓ Mund të zgjasë për aq kohë sa është e nevojshme. Zakonisht një proces i gjatë dhe i mundimshëm
- ✓ Në periudhën përpara SNKSP 33 nevojitet një strategji dhe dokument udhërrëfyes

## Periudha kalimtare

- ✓ Vjen pas futjes në zbatim të SNKSP 33
- ✓ Nuk mund të jetë më e gjatë se tre vjet
- ✓ Zbatohen përrjashtime të ndryshme
- ✓ Nuk bëhet deklaram shprehimisht dhe pa rezerva i përputhshmërisë me SNKSP-të

# Kalendari i futjes në zbatim të SNKSP-ve (nëse njësia ekonomike zbaton përjashtimet kalimtare)



# Përvoja ndërkombëtare: Përmbledhje e zbatimit për herë të parë të SNKSP-ve



11

Vendi	Qasja e zbatimit të SNKSP-ve	Qasja e vënies në zbatim të reformës	Përdorimi i SNKSP 33	Përdorimi i dispozitave kalimtare
Kosta Rika	I drejtpërdrejtë	Me faza	Jo	Po
Malajzia	I tërthortë	Me faza	Jo	Jo
Zelanda e Re	I drejtpërdrejtë	I menjëhershëm	Jo	Jo
Nigeria: Shtetet Ekiti dhe Lagos	I drejtpërdrejtë	Me faza	Po	Po
Zvicra	I drejtpërdrejtë	Me faza	Jo	Jo
Tanzania	I drejtpërdrejtë	Me faza	Jo	Po

# Përvoja ndërkombëtare: mësimet e nxjerra



- ✓ Përdorimi i metodikave të provuara të planifikimit dhe zbatimit të projektit;
- ✓ Ngritja e një komiteti drejtues ndërministror të projektit të SNKSP-ve, për të çuar përpara fazën kalimtare;
- ✓ Monitorimi i strategjisë së futjes në zbatim të SNKSP-ve dhe rivlerësimi dhe përshtatja e saj, sipas nevojës;
- ✓ Përditësimi i rregullt i organeve drejtuese përmes raporteve mbi ecurinë e zbatimit, për t'u dhënë mundësi të veprojnë kur projektet janë në rrezik të ngecjes;
- ✓ Bërja e shtesave dhe ndryshimeve në aktet ligjore, nënligjore dhe administrative në një fazë të hershme të projektit, për ta bërë të detyrueshëm kalimin për të gjitha njësitë ekonomike në fjalë;
- ✓ Shpërndarja e burimeve për projektin përmes një mekanizmi buxheti shumëvjeçar;

# Përvoja ndërkombëtare: mësimet e nxjerra



- ✓ Përcaktimi dhe parashikimi i buxhetit për burime njerëzore shtesë, që nevojiten në funksionet administrative, buxhetore dhe financiare, për të siguruar kapacitetin efektiv për kalimin drejt SNKSP-ve dhe për të ruajtur përputhshmërinë me SNKSP-të;
- ✓ Sigurimi i burimeve adekuate për formimin dhe menaxhimin e ndryshimit;
- ✓ Komunikimi i ndërgjegjësimit për ecurinë e kalimit drejt SNKSP-ve përmes të gjitha mjeteve në dispozicion të komunikimit, formimit dhe shpërndarjes;
- ✓ Përdorimi i strategjive të vlerësimit, menaxhimit dhe zbutjes së risqeve, duke mbajtur parasysh praktikat e mira ndërkombëtare për menaxhimin e projekteve;
- ✓ Integrimi i duhur midis moduleve kryesore të MFP-së, për të përfshirë, të paktën, kontabilitetin, buxhetin dhe menaxhimin e thesarit;
- ✓ Sigurimi i pavarur dhe i plotë i cilësisë së raporteve të vlerësimit të progresit.

# Rekomandime



- ✓ Të konsiderohet periudha trevjeçare kalimtare e SNKSP 33 si faza e fundit e procesit të futjes në zbatim
- ✓ Të përgatitet një strategji dhe një dokument udhërrëfyes me një grafik të besueshëm me afate kohore për reformat e kontabilitetit përpara datës së futjes në zbatim.
- ✓ Të ofrohet në vazhdimësi formim dhe rritje e kapaciteteve gjatë gjithë procesit të reformës së SNKSP-ve
- ✓ Të sigurohet bashkërendimi midis:
  - Kryesuesit të zbatimit të reformës, zakonisht Ministria e Financave ose Thesari
  - Palëve kyçe të interesit, si administrata tatimore dhe kontrolli i lartë i shtetit

# Rekomandime



- ✓ Të ndiqet një qasje me faza për vënien në zbatim të SNKSP-ve, sepse qasja e menjëhershme sjell vonesa dhe mbart rreziqe
- ✓ Të sigurohet që bilanci hapës të mos përfshijë të dhëna të vjetruara që mund të vijnë nga SIMF-ja ekzistuese ose e mëparshme
- ✓ Kur të vendoset përparësia midis standardeve SNKSP për vënien në zbatim, të mos harrohet se SNKSP 33 nuk lejon periudhë lehtësuese kalimtare trevjeçare për disa prej këtyre standardeve
- ✓ Të tregohet vetëpërmbajtje në zbatimin e dispozitave kalimtare të SNKSP 33, duke qenë se i kufizojnë përfitimet që vijnë nga futja në përdorim e SNKSP-ve në periudhën afatshkurtër dhe e zvogëlojnë integritetin dhe transparencën e pasqyrave financiare

# Faleminderit!



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




**PULSAR** 

Public Sector Accounting and Reporting Program

---

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

---